

**Nr. Prot. 035/B/18**

## VENDIM Nr. 1224

**Për**

**Miratimin e**

**“Rregullores për Shërbime Universale të Komunikimeve Elektronike”**

Në mbështetje të nenit 1, nenit 10, paragrafi 4), nenit 28 paragrafi 1) paragrafi 2) dhe paragrafi 5), dhe nenit 79, paragrafi 1) dhe 2) i Ligjit Nr. 04/L-109 për Komunikime Elektronike (*tutje referuar si - Ligji*) dhe nenit 10 paragrafi 2.1), nenit 11 paragrafi 3.3) dhe nenit 13 paragrafi 1) dhe 5) i Statutit të (*Ref. Nr.Prot.054/B/17*) të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*tutje referuar si - Autoriteti ose ARKEP*), Bordi i Autoritetit i përbërë nga:

- 1) z. Kreshnik Gashi      Kryetar i Bordit
- 2) z. Nijazi Ademja      Anëtar i Bordit
- 3) z. Hazir Hajdari      Anëtar i Bordit
- 4) z. Bahri Anadolli      Anëtar i Bordit

në mbledhjen e 29-të me radhë të mbajtur më datë 22 Qershor 2018, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur nga DKE dhe DL, unanimisht mori këtë:

## V E N D I M

- I.    Miratohet “Rregullore për Shërbimet Universale në Komunikimet Elektronike”.
- II.   Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

## A R S Y E T I M

Ligji, respektivisht neni 10, paragrafët 4) përcakton se Autoriteti: “Miraton legjislacionin sekondar lidhur me këtë ligj, të cilat janë në kompetencë të Autoritetit, mbështetur në dispozitat e këtij ligji.”

Neni 28 paragrafi 5 i Ligjit përcakton që: “Autoriteti miraton rregullat për përcaktimin e shërbimit universal si dhe të përcaktojë fushëveprimin e shërbimeve universale, kërkesat e kualitetit të shërbimit, procedurën dhe kushtet për ofrimin e shërbimit të tillë, procedurën, kushtet dhe rastet për imponimin e detyrimeve të shërbimit universal për ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike. Detyrimet e

*shërbimit universal gjithashtu mund të lidhen me të qenurit operator me fuqi të ndjeshme tregu në një treg relevant."*

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i fushëveprimit të shërbimeve universale, i kërkesave të cilësisë së shërbimit, procedurës dhe kushteve për ofrimin e shërbimit të tillë, procedurës, kushteve dhe rasteve për imponimin e detyrimeve të shërbimeve universale për ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike.

Duke pas parasyshë atë që u tha më lartë u vendos sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **Këshilla Juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit.

**Prishtinë, 04/07/2018**

**Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare**

**Kreshnik Gashi  
Kryetar i Bordit**

#### **Aktvendimi i dërgohet:**

- Ofruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike mobile;
- Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik/Departamenti i Postë Telekomunikacionit dhe Teknologjisë Informative;
- Departamentit Ligjor, ARKEP
- Departamentit të Komunikimeve Elektronike, ARKEP;
- Arkivit, ARKEP